



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:245310
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05410946

E.nr.1948/2010

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike të përmbarimore të kreditorit, Banka për Biznes me seli në Prishtinë, kundër debitorëve, N.T.P "F.....-AU", me seli në Prizren, me pronar A.U., nga Prizreni, Rr....., të cilin me autorizim e përfaqëson M.U., dhe N.P.Q."B..... Commerce" me seli në Prizren, me pronar A. B..... nga Prizreni, Rr..... pa nr, për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit – Marrëveshjes së ko lateralit të dt.06.05.2008, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kredisë në shumën prej **110.037,00 eurove**, dhe i lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate E.nr.1948/10 të dt.08.12.2010, duke vendosur përkitazi me kërkesën e datës 28.02.2024 të kreditorit Banka për Biznes me seli në Prishtinë, për shtyrjen e përmbarimit, jashtë seancës, me datën 05.03.2024, mori këtë:

KONKLUZION

APROVOHET SI E BAZUAR Kërkesa e kreditorit, Banka për Biznes me seli në Prishtinë, për shtyrjen e përmbarimit, në çështjen juridike të përmbarimit E.nr.1948/10.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren me aktvendimin e kësaj gjykate E.nr.1948/10 të dt.09.10.2013, ka caktuar propozimin për përmbarim të kreditorit të përmbarimit, Banka për Biznes me seli në Prishtinë, kundër debitorëve, N.T.P "F.....-AU", me seli në Prizren, me pronar A.U., nga Prizreni, Rr....., të cilin me autorizim e përfaqëson M.U., dhe N.P.Q."B..... Commerce" me seli në Prizren, me pronar A. B..... nga Prizreni, Rr..... – Tranzit" pa nr, për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit – Marrëveshjes së ko lateralit të dt.06.05.2008, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kredisë në shumën prej 110.037,00 eurove.

Kjo gjykatë ka ndërmarr disa veprime në funksion të përfundimit të kësaj çështje përmbarimore, ndërsa kreditori me datën 28.02.2024, përmes emailit e ka njoftuar këtë gjykatë se kanë arritur marrëveshje me debitorin "....." Sh.P.K, për pagesë të borxhit, dhe kësaj shkrese ja ka bashkangjitur Marrëveshjen për Blerjen e Pronës me këste, dhe ka kërkuar që

konform nenit 63 par.3 të LPP-së, kjo procedure përmbarimore të shtyhet në mënyrë që të kemi siguri juridike për përmbarimin e marrëveshjes e cila ka hyrë në fuqi nga data 31.08.2023 dhe deri me datën 25.12.2030.

Kjo gjykatë pas shqyrtimit të kërkesës së kreditorit Banka për Biznes me seli në Prishtinë, për shtyrjen e përmbarimit, në këtë çështje juridike të përmbarimit, vlerësoj se kërkesa në fjalë është e bazuar dhe atë për këtë arsye :

Në nenin 63 të LPP-së, që i referohet shtyrjes së përmbarimit sipas kërkesës së kreditorit, aty, thuhet: *''Në raste se palët merren vesh për pagesën e kredisë në këste, atëherë kreditori e njofton organin përmbarues për këtë marrëveshje. Ky njoftim shtynë përmbarimin gjerë në atë kohë kur kreditori njofton organin përmbarues se debitori nuk respekton kushtet e marrëveshjes së tyre, ndërsa në nenin 60 par.3 të LPP-së thuhet se, '' Organi përmbarues vendos për kërkesën për shtyrje me konkluzë.''* Në rastin konkret kërkesën për shtyrjen e përmbarimit, e ka bërë Kreditori i përmbarimit, pasi që është arritur marrëveshja me debitorin për pagesën e borxhit me këste, kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për shtyrjen e përmbarimit, andaj edhe për arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë vendosi që të aprovohet si e bazuar kërkesa e kreditorit, për shtyrjen e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit.

Nga të thënat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni, e në bazë të nenit 3 lidhur me nenin 63 par.3 të LPP-së .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

E.nr.1948/2010

Datë 05.03.2024

**Gjyqtari
Sami Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Konkluzioni nuk lejohet mjete i goditjes .